KËRKESË
Nr. 2722/2, datë 31.1.2018

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksion i oborrit të shkollës "Ali Demi", Vlorë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Vlorë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vënë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 8,796,650 (tetë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan shkreli

LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE QË SHPRONËSOHEN NGA PROJEKTI: "Rikonstruksion i oborrit të shkollës "Ali Demi", Vlorë

Çmimi për objektet sipas VKM-së 138, datë 23.3.2000, dhe udhëzimit nr. 3, datë 28.12.2016, i EKB-së Tiranë

NR.	*Z.K*	*Nr. i pasurisë*	*Adresa*	*Pronari*	*Sipërfaqe trualli m²*	*Çmimi i truallit lekë/m²*	*Vlera e truallit lekë*	*Sipërfaqe ndërtimi m²*	*Çmimi i ndërtimit lekë/m²*	*Vlera e ndërtimit lekë*	*Vlera totale truall dhe ndërtesë lekë*	*Shënime*
"Rikonstruksion i oborrit të shkollës "Ali Demi", Vlorë												
1	8603	14/104-ND	Vlorë	Dritan Hoxha				70 m² sipas certifikatës së pronësisë			8,796,650	Sipas certifikatës së pronësisë z. Dritan Hoxha ka të hipotekuar 70 m² ndërtesë, e cila është prishur dhe është miratuar leje ndërtimit nr. 5/89, datë 17.8.2010, për objekt polifunksional (social-kulturor) 4-kate me 1- kat nën tokë në lagjen "Dëshmorët", Vlorë. Vlera është përllogaritur me situacion faktik punimesh për fazën e zbatuar të objektit të ndërtuar (kati nën tokë) sipas projektit të zbatimit të miratuar.
								166.05 m² sipas sheshit dhe lejes së miratuar	Situacion punimesh			
Vlera totale e shpronësimit								**8,796,650 lekë**				